



**Hapet Thirrja për mobilitete stafi të UPT-së
në kuadër të Marrëveshjes KA1, të Programit Erasmus +
në University of Trento, Itali**

Në kuadër të marrëveshjes KA1 bilaterale, është hapur thirrja për aplikime për mobilitete për stafin e Universitetit Politeknik të Tiranës, në University of Trento, (Università di Trento), Itali.

Llojet e mobilitetit përfshijnë: Shkëmbimin e stafit administrativ, (3 staf administrativ).

Periudha e mobilitetit: 24 – 28 korrik 2023

Dokumentat e nevojshme për aplikim për stafin:

- CV;
- Kopje e Pasaportës;
- Aprovim nga përgjegjësi i njësisë bazë dhe nga përgjegjësi i njësisë kryesore, ku aplikanti bën pjesë, në lidhje me planin e mobilitetit dhe periudhën, të parashikuara për t'u kryer në universitetin pritës*;
- Dokumenti i Mobility Agreement (Staff Mobility for Training) për stafin në universitetin pritës**.

**Plani i mobilitetit për, si dhe periudha e propozuar e mobilitetit për stafin, duhet të aprovohet/firmoset paraprakisht nga përgjegjësi i njësisë bazë dhe nga përgjegjësi i njësisë kryesore ku aplikanti bën pjesë.*

*** Mobility Agreement për Training për stafin është një dokument në të cilin duhet të specifikohet programi juaj i propozuar që do të kryeni gjatë periudhës së shkëmbimit, i cili është aprovuar paraprakisht nga përgjegjësi i njësisë bazë, sipas pikës më sipër. Kjo është formë standarde e Erasmus+ dhe firmoset nga aplikanti dhe personi përgjegjës për mobilitetet në Universitetin Politeknik të Tiranës, i cili është Zv.Rektori për Anën Shkencore dhe Marrëdhëniet me Jashtë.*

[ANEKS 3 - Mobility-agreement-training, staff.pdf \(upt.al\)](#)

Afati për aplikim, pranë Drejtorisë së Komunikimit dhe Koordinimit në UPT: Deri më 5 korrik 2023, ora 12.00.

Për informacione shtesë në lidhje me procesin e aplikimit në UPT mund të kontaktoni në email: rkodra@upt.al , abeqo@upt.al